

**FJALA KUNDËR KARIKATURAVE PËR MUHAMEDIN A.S.
(TË BOTUARA NË DANIMARKË VITI 2005)**

**“Pejgamberi beson në atë që i është shpallur (Kur’ani) nga Zoti i tij, dhe besimtarët; - të gjithë ata besojnë Perëndinë, melekët (engjëjt), e tij Librat e tij dhe pejgamberëve të tij: “Na nuk dallojmë asnjërin nga pejgamberët e tij”. Ata thonë: “Na dëgjuam dhe përulemi, - Falna neve o Zoti ynë dhe te Ti do të kthehemi.”
Kur’ani Famëlartë El-Bekare, 285**

Qëllimisht këtë takim me gazetarë dhe me opinionin e gjërë të RM e fillova me këtë ajet Kur’anor me të cilin duam që t’Ju tregojmë të gjithëve Juve se cili është qëndrimi i Muhammedit a.s. dhe i muslimanëve të botës ndaj pejgamberëve të cilët i dërgoi All-llahu xh. sh. Udhërrëfyes për njerëzinë. Njëherit publikisht të deklarojmë se nuk ka muslimanë në botë i cili do të përgojonte më së paku të dërguarit e Tij, të mos flasim për sjelljet primitive dhe antinjerëzore që i bëhen Pejgamberit të fundit të All-llahut xh. sh. Muhammedit a. s. nga njerëz të cilët për fat të keq u takojnë feve monoteiste, themi për fat të keq sepse mësimet e shëndosha të feve monoteiste një sjellje të këfillë nuk e lejojnë bile e ndalojnë. Po, e ndalojnë sepse të gjitha ato kanë burimin e njejtë – Shpalljen hynore e jo mendjen dhe epshet shtazarake të njeriut.

Fundvitin e 2005 muslimanët e botës e përfunduan të ofenduar, të fyer e të sharë. Prej kujt vallë? Po, prej atyre që na shesin demokraci, prej atyre që tregohen se kanë kulturë e civilizim shumë të lartë njerëzor! Prej atyre që pretendojnë se respektojnë fjalën e lirë, prej atyre që trumpetojnë për të mirën e njeriut dhe të besimtarëve nëpërgjithësi!? Do thoni se nuk është kështu. Atëherë pra po lexojmë bashkë me ju se cka don të thotë satirë: “satirë-a – (lat. Satira, satura – përzierje) 1. ironi e hidhur, therëse e fshikulluese, qëndrim që shpreh një ironi të tillë; 2. lit. vepër letrare ose shkrim, që fshikullon të metat, veset e anët e dobëta të njerëzve dhe të shoqërisë.” Mikel Ndreca, Fjalor fjalesh e shprehjesh të huaja, botoi Rilindja 1986.

Karikaturat dhe satirat të cilat u paraqitën në shtypin perëndimor, fillimisht nga Danimarka, pamëdyshje prekën palcën e muslimanëve të botës. Të fyejsh Muhammedin a.s. don të thotë të fyejsh njërin prej gjashtë kushteve themelore të besimit Islam. Muslimanët e botës me paraqitjen e parë të satirave me përshkrim të rrejshëm për pamjen e Muhammedit a.s., në shtatorin e vitit 2005, i morrën si të rastësishme, por me ribotimin dhe paraqitjen e të njejtave nëpër botën perëndimore, vërtetë shetësuan

muslimanët sepse tani më fjala është për fyerje dhe sharje të qëllimta mu për këtë ata nuk mund të qëndrojnë indiferent ndaj tërë kësaj sjellje primitive të gazetave, të shtëpive botuese e mbi të gjitha ndaj oportunitetit të shteteve të quajtura demokratike.

Njëherit muslimanët e Maqedonisë krahas muslimanëve të botës nuk mund të pranojnë arsyetimin e qarqeve të ndryshme shtetërore, politike, qeveritare dhe joqeveritare se kjo fyerje është e drejtë e lirisë së mendimit të njeriut. Si mund të jetë e drejtë dhe liri e dikujt të fyejshë Krijuesin dhe të Dërguarin të cilëve iu beson një e treta e banorëve të botës?! Pyesim, vallë nëse më shanë e ma fyen Pejgamberin i cili më mëson si të jetoj me ty që i përket besimit tjetër, atëherë si jetojmë bashkë?

Nisur nga e tërë kjo BFI-ja me të gjitha organet dhe trupat e veta si dhe besimtarët e RM shprehin mllefin e tyre bashkë me muslimanët e botës, por ne këtë mllef do ta shprehim vërtetë në mënyrë të kulturuar dhe në mënyrë të civilizuar dhe do të përpiqemi që të frenojmë dhe t'i mbajmë muslimanët në mësimet Islame që të rrespektojnë tjetrin pavarësisht se cilit besim i takon edhe pse do të mendoni se në Maqedoni nuk ka muslimanë. Po ka muslimanë dhe do t'ju bindim Juve shumë të nderuar që na e fyet e na shatë Të dashurin tonë Muhammedin a.s. se ne do t'ua kthejmë me të mirë por kjo do të vijë vetëm atëherë kur mediatorët dhe redaksitë e gazetave që botuan këtë satirë të kërkojnë flaje publike muslimanëve të botës dhe të Maqedonisë. Këtë falje na e kanë borxh para së gjithash gazetave e quajtura të pavarura dhe demokratike të nënqiellit të Maqedonisë.

Duke dashur që në tërë botën por edhe në Maqedoni dhe në rajon të sundojë paqë kërkojmë nga të gjithë muslimanët që në mënyrë dinjitoze të përmbahen nga provokimet të cilat vazhdimisht bëhen në mjedise tona me qëllime të caktuara. Para së gjithash lusim studentët që të mbajnë veten dhe të mos bien nën provokime të mbrapshta.

BFI-ja kërkon nga të gjitha imamët e xhamive që dita e xhumasë së datës dhjetë dhe shtatmbëdhjetë shkurt t'i kushtohet ekskluzivisht jetës dhe veprimtarisë së Muhammedit a.s. me këtë do të freskojmë shpirtin e muslimanëve dhe ne në këtë mënyrë do t'iu kundërvihemi sharjeve dhe fyerjeve që na i bëjnë demokratët dhe liridashësit.

Na vjen shumë keq për dëmet të cilat janë shkaktuar si rezultat i protestave dhe tubimeve që janë mbajtur nëpër botë, por ne i kuptojmë ata sepse ua kanë prekur palcën. Do dëshironim që këto protesta të jenë të qeta, pa dëme dhe pa viktime.